



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:905183

Datë: 02.08.2021

Numri i dokumentit: 02053920

Ac.nr.1626/2018

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hunaida Pasuli – kryetare e kolegjit, Gani Avdiu dhe Faton Ademi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit SH.GJ. nga Peja, kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (tani Telekomi i Kosovës), sh.a me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Gazmend Loshi, me objekt kontesti anulimi i vendimit për caktimin e lartësisë së të ardhurave personale dhe kompensim i diferencës së pagave, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.788/17 të datës 06.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.07.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës Telekomi i Kosovës sh a Prishtinë (ish Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës), ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr. 788/17, i datës 06.02.2018, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë me aktgjykimin e atakuar C.nr.788/17 të datës 06.02.2018 ka vendosur si në vijim:

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit SH.GJ. nga Peja
- II. ANULOHET aktvendimi i të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Nr. 01-1040-1281/2012 i dt. 07.03.2012 dhe DETYROHET e paditura Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës në Prishtinë që paditësit SH.GJ. nga Peja në emër të

kompensimit të pagës për periudhën kontestuese datë 01.02.2012 e gjer me datë 31.12.2014 t'ia paguaj shumën prej 3173.36€ për ndryshimin e pagës, të bonusit si dhe të trustit në emër të gradës 6 dhe 5, si dhe kamatën ligjore në shumë prej 490,65€ në total në shumë prej 3.664.01€, me kamatë siç paguajnë bankat përkatëse duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit dt. 06.02.2018, e deri në pagesën definitive si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 195€, e të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka parashtruar e paditura për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta hedhë si të pasafatshëm padinë, apo ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi Gent Gjokolli nga Peja me datë 04.02.2014, në Gjykatën Themelore në Pejë ka parashtruar padi kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.a, me seli në Prishtinë për anulimin e vendimit për caktimin e lartësisë së të ardhurave personale dhe kompensimin e diferencës së pagave, me arsye dhe kërkesë si në padi.

Duke vepruar sipas padisë, gjykata e shkallës së parë me datë 13.04.2016 ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor në të cilën seancë, bazuar në deklaratimet e palëve ndërgjyqëse dhe në provat shkresore, vlerësoi se padia është e pasafatshme dhe rrjedhimisht me aktvendimin C.nr. 87/14 datë 13.04.2016, të njëjtën e hodhi poshtë si të palejuar.

Me aprovimin e ankesës së paditësit nga gjykata e shkallës së dytë lënda është kthyer në rivendosje, me konstatimet se gjykata e shkallës së parë gabimisht i ka zbatuar dispozitat e nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, meqë padiësi nuk i ka lëshuar afatet ligjore për paraqitjen e padisë, marrë parasysh se kërkesa ka të bëjë me kompensimin e diferencës së pagës për të cilën kërkesë në kuptim të nenit 87 t Ligjit të Punës parashihet afati trevjeçar i parashkrimit. Mbi bazën e këtyre konstatimeve gjykata e shkallës së parë është udhëzuar që në riprocedurë faktet e pohuara t'i vërtetoj me prova materiale dhe varësisht nga gjendja faktike të vendos për themelësinë e kërkesëpadisë, respektivisht për aprovimin ose refuzimin e kërkesëpadisë.

Në riprocedurë, duke vepruar sipas vërejtjeve të dhëna në aktvendimin e Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë caktoi seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën administroi provat e propozuara nga ndërgjyqësit. Mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar vlerësoi se kërkesëpadia është e bazuar dhe të njëjtën e aprovoi, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar gjykata ka parashtruar se nuk është kontestues që me kontratën e punës me nr. 01-2880-1236/11 të datës 20.10.2011, (të lidhur mes ndërgjyqësve), palët janë pajtuar që paditësi për vendin e punës zyrtar për shitje dhe kujdes ndaj konsumatorëve të realizoj pagë mujore nga grada 6, dhe që derisa kontrata ishte ende në fuqi, e paditura me aktvendimin nr. 01-1040-1281/2012 të datës 07.03.2012, ka vendosur që paditësit t'i ulet paga mujore në lartësi të gradës 5. Po ashtu nuk ishte kontestues që kundër këtij aktvendimi paditësi ka parashtruar ankesë për korrigjimin e pagës nga grada 5 në 6, ndërsa e paditura nuk ka vepruar sipas ankesës në fjalë, respektivisht ka vazhduar që paditësit t'i paguaj pagën më të ultë nga paga e kontraktuar. Si kontestues ishte ligjshmëria e aktvendimit për caktimin e lartësisë së pagës sipas gradës 5, prandaj në këtë drejtim gjykata i vlerësoi provat vendimtare, duke gjetur se e paditura ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 10;11; 55 dhe 56 të Ligjit të Punës dhe nenit 5 të kontratës së punës, pasi përkundër marrëveshjes së palëve, në mënyrë të njëanshme ka vendosur t'i ndryshoj kushtet e kontratës, duke e dëmtuar paditësin në realizimin e të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës. Nga kjo bazë, gjykata përveç anulimit të vendimit, e detyroi të paditurën që paditësit t'i paguaj diferencën në pagë në shumën e gjykuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë, Gjykata e Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara në ankesë. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë dhe i ekzaminueshëm. Në aktgjykim janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, nga të cilët është vërtetuar themelësia e kërkesëpadisë. Rrjedhimisht, gjykata e shkallës së dytë e ka vlerësuar si të pambështetur pretendimin ankimor për vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, pasi siç rezulton nga shkresat e lëndës, gjykata e çështjes me kujdes i ka çmuar të gjitha provat e propozuara nga ndërgjyqësit, duke konstatuar drejtë se disa fakte për palët në procedurë nuk ishin kontestues dhe atë se me kontratën e punës nr. 01-2880-1236/11 të datës 20.10.2011, paditësit i është caktuar paga në lartësi të gradës 6, ndërsa sipas aktvendimit të të paditurës të datë 07.03.2012 (me efekt nga data 01.02.2012), paditësit i është zbritur paga në gradën 5. Nga faktet e rastit ka rezultuar se paditësi është dëmtuar në pagë në kundërshtim me dispozitat e ligjit të punës si dhe me vetë kontratën e punës, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur ta anuloj si të kundërligjshëm aktvendimin kontestues, me të cilin paditësit, pa vullnetin e tij, dhe pa ndonjë arsye të qëndrueshme i është zbritur paga. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, është vlerësim i gjykatës ankimore se në raport me faktet e rastit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar ligjin material nga neni 11 dhe 55 i Ligjit për punë, duke e detyruar të paditurën të paguaj diferencën në pagë për periudhën kohore nga data 01.02.2012 (kur aktvendimi i kontestuar ka hyrë në fuqi) e deri me datë 31.12.2014, kur palët ndërgjyqëse pas kësaj date kanë lidhur kontratë të re të punës.

Meqë lartësia e detyrimit në emër të duferencës në pagë është provuar me ekspertizën financiare, - këtë provë e pranoi si të besueshme edhe gjykata e shkallës së dytë, pasi ekspertiza është mirë e argumentuar sa i përket diferencës së të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës sikurse edhe të detyrimit për pagesën e trustit nga ana e të paditurës.

Gjykata e Apelit nuk e pranon të bazuar pretendimin ankimor të palës së paditur se paditësit i është ulur paga mujore mbi bazën e vendimit të aksionarit - MZHE (Ministrisë për Zhvillim Ekonomik), për faktin se nga përmbajtja e vendimit të referuar, rezulton se i njëjti ka karakter rekomandues për të paditurën në drejtim të uljes së shpenzimeve në PTK, - në raport me të hyrat e përgjithshme. Meqenëse, gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore, në gjykatën e shkallës së parë e paditura nuk ka dëshmuar se ka miratuar ndonjë plan për zbatimin e rekomandimeve të aksionarit MZHE-së, apo që për vendet përkatëse të punës të ketë nxjerrë rregullore për caktimin e lartësisë së të ardhurave personale, prandaj ky pretendim vlerësohet si i pambështetur dhe pa ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe përkitazi me ankesën e të paditurës në çështjen konkrete juridike.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore që gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar gabimisht i është referuar nenit 87 të Ligjit për punë, kur ka vlerësuar afatshmërinë e padisë, kjo për arsye se kërkesëpadia e paditësit ka të bëjë me realizimin e kërkesave në para, e që sipas nenit 87 të Ligjit për punë, kërkesat e tilla vjetërsohen pas kalimit të afatit kohor prej tre vitesh. Me referim në faktet e rastit rezulton se padia është e afatshme për arsye se paditësi është dëmtuar në pagë sipas aktvendimit të datës 07.03.2012, ndërsa padinë në gjykatë e ka parashtuar më 04.02.2014, pra brenda afatit kohor trevjeçar, të përcaktuar në nenin 87 të Ligjit për Punë.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e theksuara më sipër dhe në pajtim me dispozitën nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1, pika d) dhe neni 200 të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1626/2018 me datë 23.07.2021

Kryetare e Kolegjit - Gjyqtarja,
Hunaida Pasuli